



Projekt – twining i BE-së „Mbështetje në zbatimin e kornizës së modernizuar ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale”



UDHËZUES PËR SHFRYTËZIMIN E **BISKOTAVE**



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian





PËRMBAJTJA

1. ÇKA JANË BISKOTAT DHE ÇFARË LLOJE TË BISKOTAVE EKZISTOJNË?	3
2. Dispozitat ligjore që kanë të bëjnë në grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet biskotave.....	6
3. Biskotat të cilat nuk imponojnë dhënie të pëlqimit	8
4. Pëlqim për grumbullimin e të dhënave personale nëpërmjet biskotave	11
5. Deklaratë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet biskotave.....	22



1. ÇKA JANË BISKOTAT DHE ÇFARË LLOJE TË BISKOTAVE EKZISTOJNË?

Biskotat (cookies) janë skeda të vogla të cilat internet-kërkuesi i ruan në kompjuter, pajisjen mobile ose në pajisje tjetër që shfrytëzuesi e përdor për vizitë të ueb faqeve. Ato ruhen sipas “urdhrit” të vetë ueb faqes, për nevojat e tij të ardhshme. Nevojat e tilla janë të ndryshme dhe varen nga qëllimi i biskotave, për shembull, biskotat mund të grumbullojnë informacione për: zgjedhjen e paraqitjes në më shumë gjuhë në faqet e ueb faqes dhe radhitjen e faqeve të kontrolluara që shfrytëzuesi të mund të kthehet në faqet e njëjta sipas radhitjes së njëjtë; listën e sendeve që shfrytëzuesi i ka futur në shportë të ndonjë onlajn shitoreje; të dhënat lidhur me cilësimet për pëlqim të shfrytëzimit të biskotave; si dhe informacione për IP adresën, të dhëna për autencitetin, e-mejl adresën, gjeolokacionin e shfrytëzuesit, nëse vizitori shfrytëzon kompjuter ose pajisje mobile, cila faqe të ueb faqes janë vizituar, etj.

Biskotat janë ndarë në disa grupe, sipas kohëzgjatjes, burimit dhe funksionit të tyre.

Nga aspekti i kohëzgjatjes, biskotat mund të jenë:

- **Biskota të përhershme**- ato janë biskota që mbeten në kompjuter ose pajisjen që shfrytëzohet për vizitë të ueb faqeve pas mbylljes së kërkuesit. Ato u ndihmojnë ueb faqeve të ruajnë informata, për shembull, cilësime gjuhësore ose cilësime për pëlqim të shfrytëzimit të biskotave në mënyrë që shfrytëzuesi të mos detyrohet sërish t’i fusë në kërkues çdo herë kur dëshiron të vizitojë ueb faqet e njëjta. Biskotat e përhershme mund të mbeten në kompjuter ose pajisje që shfrytëzohet për vizitë të ueb faqeve me ditë, muaj, madje edhe me vite.
- **Biskotat e përkohshme ose biskotat për sesione**- ato janë biskota të cilat do të largohen nga kompjuteri ose pajisja që shfrytëzohet për vizitë të ueb faqeve pas mbylljes së kërkuesit. Ueb faqet i shfrytëzojnë këto biskota për ruajtjen e të dhënave të përkohshme, për shembull, disa faqe të fundit të ueb faqes të cilën shfrytëzuesi i ka vizituar ose sendet të cilat shfrytëzuesi i ka vënë në shportë gjatë vizitës së ueb faqes e cila funksionin si onlajn shitore.

Sipas burimit, biskotat mund të jenë:

- **biskotat e vendosura nga faqja e parë**- ato janë biskota që e ruajnë ueb faqen e cila është vizituar së pari nga shfrytëzuesi, për shembull, biskotat që një onlajn shitore i shfrytëzon për ruajtjen e sendeve të cilat klienti i ka vënë në shportë ose biskota për sesion.
- **biskota të vendosura nga palë të treta**- nëse ato biskota që i ruajnë ueb faqe tjera ose shërbime onlajn të cilat janë pjesë nga ueb faqja që shfrytëzuesi i ka vizituar paraprakisht. Zakonisht, ueb faqet tjera i shfrytëzojnë këto biskota që t’i ndjekin shprehitë e shfrytëzuesit të ueb faqes së parë ose i shfrytëzojnë shërbimet onlajn

për sigurimin e kualitetit të shërbimit të tyre (për shembull për interaksion me shfrytëzuesin e ueb faqeve e shfrytëzojnë funksionin " bisedë onlajn" e cila e ruan numrin identifikues të shfrytëzuesit që ta dijë se kujt t'ia dërgojë mesazhin konkret).

Sipas funksionit, ekzistojnë disa lloje të biskotave, kurse më të zakonshmet janë:

- **biskotat teknike/të domosdoshme**- ato janë biskota që janë të nevojshme për funksionim të ueb faqes dhe qëllimet e saj bazë, për shembull, identifikuesi për sesionin në vizitën momentale të shfrytëzuesit ose përmbajtjen e shportës të cilën shfrytëzuesi e ka "mbushur" gjatë blerjes së shites onlajn.
- **biskota funksionale**- janë biskota që i mundësojnë ueb faqes të sigurojë funksionalitet më të mirë dhe personalizim, për shembull, nëpërmjet memorizimit të gjuhës për shfaqjen e përmbajtjes të faqeve nga ueb faqja ose të dhëna për pajtim të shfrytëzuesit për përpunimin e të dhënave personale të tij/saj nëpërmjet biskotave.
- **biskotat statistikore**- ato janë biskota që grumbullojnë informacione për mënyrën në të cilën shfrytëzuesit i vizitojnë ueb faqet dhe faqet e atyre ueb faqeve.
- **biskotat e marketingut** – ato janë biskota që grumbullojnë informacione për shprehitë dhe sjelljen e shfrytëzuesit të ueb faqes që mund të shfaqin reklama të individualizuara.

Për ndjekje më të lehtë të përmbajtjes së këtij Udhëzuesi, së pari duhet të sqarohet koncepti “pajisje terminale” që shfrytëzohet në Ligjin për komunikime elektronike në Republikën e Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” numër 39/2014, 188/2014, 44/2015, 193/2015, 11/2018 dhe 21/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV-së” numër 98/2019 dhe 153/2019), respektivisht neni 168, paragrafi (6) i cili e rregullon grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave personale të cilat ruhen në pajisjen e personave për lidhje të internetit dhe për kërkime dhe kontroll të ueb faqeve.

Pajisje terminale është çdo pajisje elektronike, siç është kompjuteri, laptopi, tableti ose çfarëdo pajisje tjetër që mund të lidhet në internet, të kërkojë ueb faqe dhe të ketë aftësi të ruaj biskota ose të shfrytëzojë metodë tjetër ose teknologji për ruajtjen e të dhënave të shfrytëzuesit.

Është e rëndësishme të përmendet se pajisja terminale, përveç biskotave mund të grumbullojë edhe të dhëna tjera personale për shfrytëzuesin, me ç'rast një nga mënyrat më të zakonshme për atë janë objektet lokale për ruajtje / flesh- biskotat (flash cookies), goust-biskotat (ghost cookies), piksel - traker (pixel trackers), pajisje për zhvillim të softuerit (SDK), teknologji për gjurmë të gishtave, etj.

Së këtejmi, kur kontrolluesit shfrytëzojnë ueb faqe si pjesë e aktivitetit të tyre të punës për sigurim ose reklamim të shërbimeve, ata duhet të konsultohen me zhvilluesit/dizajnuesit e ueb faqeve që të kontrollojnë nëse ueb faqja e tyre shfrytëzon biskota ose teknologji tjera për grumbullimin e të dhënave për shfrytëzuesit në pajisjen



Projekt – twining i BE-së „Mbështetje në zbatimin e kornizës së modernizuar ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale”

e tyre termale. Nëse shfrytëzon teknologji të tilla, ueb faqja duhet të jetë e harmonizuar me dispozitat ligjore të cilat kanë të bëjnë në grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet biskotave. Edhe pse ky Udhëzues ka të bëjë me shfrytëzimin e biskotave, rekomandimet e dhëna më poshtë janë valide edhe për mënyra tjera për grumbullim dhe përpunim të të dhënave personale të pajisjes terminale të shfrytëzuesve.



2. DISPOZITAT LIGJORE QË KANË TË BËJNË NË GRUMBULLIMIN DHE PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NËPËRMJET BISKOTAVE

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shfrytëzimi i biskotave (ose ndonjë mënyrë tjetër për ruajtjen e informacioneve të pajisjes terminale të shfrytëzuesit) është rregulluar në Ligjin për komunikime elektronike ("Gazeta Zyrtare e RM-së" numër 39/2014, 188/2014, 44/2015, 193/2015, 11/2018 dhe 21/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" numër 98/2019 dhe 153/2019), ku neni 168, paragrafi (6) përcakton se: "Ruajtja e informacioneve ose marrja e qasjes të informacionet të cilat tani më ruhen në pajisjen terminale të parapaguesit ose shfrytëzuesit është e lejuar vetëm nëse parapaguesi i prekur ose shfrytëzuesi ka dhënë pëlqim, pasi i janë dhënë informacione të qarta dhe gjithëpërfshirëse në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale. Veprimet e tilla nuk duhet ta pengojnë ruajtjen teknike ose qasjen të informacionet për qëllimet e mundësimit të bartjes së komunikimit nëpërmjet rrjetit komunikues elektronik publik ose kur ajo është e domosdoshme për qëllimet e sigurimit të shërbimeve informatike të cilat janë kërkuar në mënyrë eksplicite nga ana e parapaguesit ose shfrytëzuesit të shërbimit."

Me fjalë tjera, instalimi i biskotave ose leximi i informacioneve të cilat tani më ruhen për personin e pajisjes terminale mund të bëhet vetëm nëse personi ka dhënë pëlqim, pasi i janë dhënë informacione të qarta për atë cilat të dhëna do të grumbullohen dhe për çfarë qëllimi, në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga ky rregull për kërkesa dhe dhënien e pëlqimit janë përjashtuar vetëm biskotat të cilat janë teknikisht të domosdoshme për mundësim të komunikimit ndërmjet pajisjes terminale të shfrytëzuesit dhe ueb faqes të cilën ai/ajo viziton ose për sigurimin e shërbimit që ueb faqja e jep me kërkesë të shfrytëzuesit.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale (në tekstin e më poshtëm: LMDHP) ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" numër 42/20 rregullon:

- çka paraqet e dhëna personale;
- kush mund të përpunojë ligjërisht të dhëna personale (grumbullim dhe shfrytëzim të të dhënave personale);
- si përpunohen të dhënat personale në mënyrë ligjore;
- cilat të drejta i kanë personat fizikë të dhënat personale të të cilëve përpunohen (shfrytëzues);
- cilat janë detyrimet e atyre të cilët përpunojnë të dhëna personale për nevojat e aktivitetit të tyre afarist (kontrollues);
- cilat janë obligimet e atyre që përpunojnë të dhëna personale për nevojat e personit tjetër juridik (përpunues);
- kush është përgjegjës për kryerjen e mbikëqyrjes për zbatimin e LMDHP.

LMDHP definojnë se e dhënë personale është çdo informatë që ka të bëjë me person fizik të identifikuar ose person fizik i cili mund të identifikohet (subjekt i të dhënave personale), kurse person fizik i cili mund të identifikohet është personi identiteti i të cilit mund të përcaktohet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, veçanërisht në bazë të identifikuesit siç janë emri dhe mbiemri, numri amë i qytetarit, të dhëna për lokacionin, identifikator nëpërmjet internetit, ose në bazë të një ose më shumë veçorive specifike për identitetin e tij fizik, fiziologjik, gjenetik, mental, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.

Përveç kësaj, LMDHP definojnë edhe kategori të posaçme të të dhënave personale, respektivisht të dhëna të cilat zbulojnë origjinë racore ose etnike, qëndrime politike, fetare ose bindje filozofike, ose anëtarësi në sindikata, si dhe të dhëna gjenetike, të dhëna biometrike për identifikim të vetëm të ndonjë personi fizik, të dhëna për shëndetin ose të dhëna për jetën seksuale ose orientimin seksual të personit. Të dhënat e tilla nuk guxojnë të përpunohen përveç nëse nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 13, paragrafin (2) të LMDHP-së.

Në pajtim me LMDHP, një nga baza juridike për përpunimin ligjor të të dhënave personale është pëlqimi. Kur grumbullimi/përpunimi i të dhënave personale bazohet në pëlqim, kontrolluesit duhet të jenë në mundësi të tregojnë se subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqim vullnetar, se ka qenë paraprakisht i informuar dhe se kërkesa për dhënien e pëlqimit i është prezantuar në mënyrë në të cilën qartë është ndarë nga çështjet tjera, dhe në formë të kuptueshme dhe lehtë të qasshme, me shfrytëzimin e gjuhës së thjeshtë dhe të qartë, por edhe me theksim të qëllimit të përpunimit të të dhënave personale. Gjithashtu, subjektet e të dhënave personale duhet të kenë mundësi për tërheqjen e pëlqimit në cilën do kohë, dhe atë në mënyrë të thjeshtë njësoj sikur edhe dhënia e pëlqimit.

Më tej, LMDHP përcakton se kur kontrolluesit grumbullojnë të dhëna personale drejtpërdrejt nga subjekti i të dhënave personale, në momentin e grumbullimit të të dhënave ata janë të obliguar ta informojnë subjektin e të dhënave personale për (kjo është pjesë nga parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës):

- identitetin dhe kontakt detalet e kontrolluesit;
- kontakt detale të oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale
- qëllimet e përpunimit për të cilën janë dedikuar të dhënat personale, si dhe baza juridike për përpunim;
- nëse përpunimi bazohet në interes legjitim të kontrolluesit ose të ndonjë pale të tretë;
- shfrytëzuesit ose kategoritë e shfrytëzuesve të të dhënave personale;
- nëse të dhënat personale barten në vende të treta;
- cili është afati për ruajtjen e të dhënave personale;
- të drejtat e subjektit të të dhënave personale për qasje të të dhënave personale, korrigjim, shlyerje ose kufizim të përpunimit;

- të drejtën e subjektit të të dhënave personale ta tërheqë pëlqimin nëse përpunimi bazohet në pëlqim;
- të drejtën e subjektit të të dhënave personale për të paraqitur ankesë te Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AMDHP);
- nëse dhënia e të dhënave personale është detyrim ligjor, kusht për kryerjen e marrëveshjes ose kusht për lidhje të marrëveshjes, si dhe ajo nëse subjekti i të dhënave personale është i detyruar t'i japë të dhënat personale të tij/saj.

3. BISKOTAT TË CILAT NUK IMPONOJNË DHËNIE TË PËLQIMIT

Ligji për komunikime elektronike përcakton se biskotat të cilat janë teknikisht të domosdoshme për mundësimin e komunikimit ndërmjet pajisjes terminale të shfrytëzuesit dhe ueb faqes që vizitohet ose sigurimi i shërbimit që ueb faqja e jep me kërkesë të shfrytëzuesit nuk imponon marrje ose dhënie të pëlqimit.

Nga këtu mund të konkludohet se ekzistojnë dy lloje të përjashtimeve të cilat janë të njohura si : a) përjashtim për komunikim; dhe b) përjashtim për domosdoshmëri.

a) **Përjashtimi për komunikim** zbatohet në biskotat qëllimi i të cilave është të mundësojë transmetim të komunikimit nëpërmjet ndonjë rrjeti, përkatësisht, t'i identifikojë pika përfundimtare të komunikimit, ose biskotat që shfrytëzohen për mundësim të këmbimit të sendeve të cila janë pjesë e porosisë së planifikuar, për shembull, numërimi i pakove, ose biskotat që shfrytëzohen për detektim të gabimeve ose humbjen e të dhënave gjatë transmetimit. Nga ana tjetër, biskotat shfrytëzohen që ta ndihmojnë, shpejtojnë ose rregullojnë bartjen e komunikimit nëpërmjet ndonjë rrjeti nuk hyjnë në këtë përjashtim për kërkesë dhe dhënie të pëlqimit.

b) **Përjashtimi për domosdoshmëri** zbatohet në “ shërbimet e shoqërisë informatike”- shërbime që mundësohet nëpërmjet internetit, siç janë ueb faqet ose aplikacionet, por këto biskota i nënshtrohen zbatimit të dy testeve, përkatësisht shërbimi duhet të jetë i kërkuar në mënyrë eksplicite nga shfrytëzuesi dhe shfrytëzimi i biskotave duhet të kufizohet vetëm në atë që është rreptësisht e domosdoshme për sigurimin e shërbimit konkret.

Në parim, biskotat të cilat nuk imponojnë kërkesë dhe marrje të pëlqimit bien në një nga grupet e biskotave si vijojnë:

1. **Biskotat për "input nga shfrytëzuesi"**- zakonisht ato janë biskota të vendosura nga faqja e parë të cilat shfrytëzohen, për shembull ndjekja e inputeve nga shfrytëzuesi kur mbush formular onlajn ose për ndjekjen e prodhimeve/sendeve që shfrytëzuesi i ka zgjedhur nëpërmjet klikimit të funksionit "shto në shportë" si pjesë e blerjes onlajn.



2. **Biskota për interfejs të personalizuar-** zakonisht ato janë biskota të përhershme të vendosura nga faqja e parë që shfrytëzohen, për shembull, për zgjedhjen e gjuhës së paraqitjes së faqes nga ueb faqja ose për zgjedhjen e shfrytëzuesit në lidhje me opsionet për qasje te ueb faqja.
3. **Biskota për autentifikim-** zakonisht ato janë biskota për sesione të cilat shfrytëzohen për identifikim të shfrytëzuesit pasi që ai/ajo është lajmëruar, për shembull, për qasje deri te aplikacioni për bankieri interneti. Këto biskota janë të nevojshme që të mundësojnë qasje deri tek përmbajtjet e autorizuara të shfrytëzuesit, për shembull, pasqyrë e llogarisë së tij vijuese, transaksione, etj., pa pasur nevojë për autorizim (lajmërim) për shfrytëzimin e çdo opsioni.
4. **Biskotat e sigurisë për shfrytëzuesin-** zakonisht janë biskota të përhershme me afat të kufizuar për ruajtje pas mbarimit të sesionit dhe ato shfrytëzohen, për shembull, për detektim të tentimeve të pasuksesshme të përsëritura për paraqitje në ueb faqe ose mekanizëm tjetër të ngjashëm për mbrojtjen e sistemit për paraqitje për keqpërdorime të mundshme.
5. **Biskotat për sesion të lexuesit të përmbajtjes-** zakonisht ato janë biskota që shfrytëzohen për ruajtjen e të dhënave teknike të cilat janë të nevojshme për leximin e video ose audio përmbajtjeve të ueb faqes, për shembull, kualiteti i fotografisë, shpejtësia e koneksionit të rrjetit dhe parametrat- bafer.
6. **Biskota për sesion për balancim të ngarkimit-** ato janë biskota për sesion të cilat, në varësi të ngarkimit të internetit individual serveri në të cilin ruhen përmbajtjet të cilat shfrytëzuesi dëshiron t'i vizitojë, mundëson ridrejtim në server më pak të ngarkuar.
7. **Biskotat për ndarjen e përmbajtjeve të mediave sociale-** ato janë biskota për sesion të cilat shfrytëzuesve të cilët janë kyçur në ndonjë rrjet social në moment kur vizitojnë ndonjë ueb faqe ka ikona për media sociale u mundëson të ndajnë përmbajtje nga ueb faqja në profilin e tyre shfrytëzues në ndonjë nga rrjetet sociale.

Është e rëndësishme të theksohet se edhe pse biskotat kanë më shumë funksione (për shembull, biskotat për input nga shfrytëzuesi që shfrytëzohen për ndjekjen e prodhimeve/sendeve të cilat shfrytëzuesi i ka zgjedhur me klikim të funksionit " shto në shportë" gjatë kohës së blerjes onlajn, gjithashtu mund të shfrytëzohen edhe për ndjekjen e shprehive të shfrytëzuesit për qëllimet e shfaqjes së reklamave të personalizuara) me qëllim që biskota tjera të mos imponojnë kërkesë dhe dhënie të pëlqimit që shfrytëzuesi të ketë vetëm një funksion nga grupi konkret i biskotave. Në të kundërtën, ato e humbin këtë "privilegj" dhe bëhen biskota për të cilat duhet të kërkohej dhe merret pëlqim. Nga aspekti i mbrojtjes të të dhënave personale, rekomandohet kontrolluesit të mos shfrytëzojnë biskota me më shumë funksione, por të shfrytëzojnë një biskotë për qëllimet të cilat nuk imponojnë pëlqim dhe biskotë tjetër për qëllimet e grumbullimit dhe



përpunimit të të dhënave personale të cilat i nënshtrohen kërkesës për dhënien e pëlqimit, si dhe dy lloje të qëllimeve mund të jenë të përfshira me shfrytëzimin e vetëm një biskote.

Edhe pse, sipas dispozitave nga ligji për komunikime elektronike, këto grupe të biskotave nuk imponojnë kërkesë dhe marrjen e pëlqimit, në rast kur ndonjë biskotë nga ky grup përpunon të dhëna personale të shfrytëzuesit duhet t'i jepen informacione për përpunimin e të dhënave personale në pajtim me parimin e ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës nga LMDHP .

Shembuj për biskota të cilat nuk imponojnë kërkesë dhe marrje të pëlqimit:

Ueb faqja siguron shërbime të shitores onlajn dhe që të jenë në mundësi që t'i ndjekin sendet që shfrytëzuesit i vënë në shportën virtuale dhe për atë qëllim shfrytëzon biskota për sesion që të mund t'i mbajë mend sendet e shfrytëzuesit në shportë të cilat më pas fshihen pasi që shfrytëzuesi do të ç'lajmërohet ose do ta kryejë blerjen. Këto biskota bien në kategorinë e biskotave për “inpute nga shfrytëzuesi”, grumbullohen vetëm për qëllimin e dedikuar dhe nuk imponojnë kërkesë dhe marrje të pëlqimit.

Nga ana tjetër, kur biskotat e njëjta, në mënyrë plotësuese për qëllimin primar, shfrytëzohen edhe për ndjekjen e shprehive të shfrytëzuesit për qëllime të shfaqjes së reklamave të personalizuar, atëherë ato nuk i plotësojnë kushtet për biskota që nuk imponojnë pëlqim dhe shfrytëzuesi duhet të japë pëlqim që ato të mund të shfrytëzohen.

Ueb faqet kanë mundësi për shfaqjen e përmbajtjeve të tyre në më shumë gjuhë ndërkombëtare, si dhe mundësi për ndryshimin e shfaqjes së përmbajtjeve të ndonjë faqeje nga ueb faqja. Që ta mbajnë mend gjuhën që shfrytëzuesi e ka zgjedhur gjatë shfaqjes së përmbajtjes dhe dizajni i faqeve, shitoret onlajn i ruajnë këto informacione në biskotat. Edhe ky grup i biskotave nuk imponon kërkesa dhe marrje të pëlqimit nga shfrytëzuesi.

Kur ndonjë ueb faqe siguron shërbime për postë elektronike, duke pasur parasysh atë se shfrytëzuesit e autorizuar të këtij shërbimi nuk duhet të lajmërohen çdo herë shfrytëzojnë ndonjë nga opsionet e mundshme që i mundëson posta elektronike në rutinë e tyre (kontroll e postës së arritur, fshirja e- mejleve, krijimi i adresave, dërgimi i postës...), pas lajmërimit të parë të suksesshëm të shfrytëzuesit të ueb faqes i ruan të dhënat për lajmërim të suksesshëm të shfrytëzuesit në biskotat të cilat shfrytëzohen për atë qëllim. Edhe ky grup i biskotave nuk imponon kërkesa dhe marrje të pëlqimit .

4. PËLQIM PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NËPËRMJET BISKOTAVE

Biskotat të cilat nuk i plotësojnë kriteret e dhëna në kapitullin paraprak imponojnë kërkesë për dhënien e pëlqimit për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet biskotave.

Është me rëndësi të theksohet se pas leximit të faqes së parë të ndonjë ueb faqeje, për shfrytëzuesin të vazhdojë me shikim të faqeve tjera nga ueb faqja e pajisjes terminale e tij nuk guxojnë të vendosen çfarëdo biskota të cilat imponojnë pëlqim derisa shfrytëzuesi nuk jep pëlqim për ruajtjen e biskotave të tilla. Nëse shfrytëzuesi nuk ka dhënë pëlqim, në pajisjen terminale ruhen vetëm biskotat për të cilat nuk ka nevojë për pëlqim.

Në vetë ueb faqet, kërkesa për dhënien e pëlqimit për grumbullimin e të dhënave nëpërmjet biskotave zakonisht paraqiten në dritare lëvizëse ose në afishe të veçantë në marginat e shfaqjes së përmbajtjes së ueb faqes, dhe më shpesh gjendet në fund të paraqitjes në ekran.

Kur kërkohet pëlqim për grumbullimin e të dhënave personale nëpërmjet biskotave, është me rëndësi të mbahet mend se, sipas LMDHP , pëlqimi nuk guxon të jetë i kushtëzuar. Shfrytëzuesit duhet t'i sqarohet vëllimi i të dhënave personale që do të grumbullohen edhe për çfarë qëllimi, dhe atë në gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, që ai/ajo të mund në mënyrë të pavarur të vendosë nëse do të japë pëlqim për përpunimin e vëllimit konkret të të dhënave. Njësoj e rëndësishme është të mbahet mend se, sipas LMDHP-së , pëlqim duhet të jepet për çdo lloj të biskotave dhe për çdo funksion të biskotave në veçanti, përkatësisht pëlqimi nuk mund të kombinohet për të gjitha biskotat të cilat grumbullojnë të dhëna për qëllime të ndryshme të përpunimit të të dhënave personale.

Shembuj për pëlqimin e kushtëzuar për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet biskotave janë dritaret lëvizëse ose afishe me njoftim për shfrytëzuesin me formulimin si vijon: “ Kjo ueb faqe shfrytëzon biskota. Pranimi i biskotave mundëson kërkim optimal të përmbajtjes së ueb faqes.”, ose afishe me njoftim për shfrytëzuesin me formulimin si vijon: “ Ne shfrytëzojmë biskota që ta përmirësojmë përvojën gjatë shfrytëzimit të ueb faqes tonë. Me klikim të cilit do link në këtë faqe, ju e pranoni shfrytëzimin e biskotave.”, ose butoni me tekst “PRANO” ose “OK” pa ju dhënë mundësi shfrytëzuesit t'i zgjedhë grupet të biskotave sipas qëllimit të tyre për të cilat dëshiron të japë pëlqim. Shembujt e tillë nuk plotësojnë asnjë nga kushtet të cilat paraqesin bazë legjitime për grumbullimin e të dhënave personale. Një kërkesë e tillë për pëlqim nuk i sqaron shfrytëzuesit cili është vëllimi i të dhënave personale që do të grumbullohen dhe për çfarë qëllimi, dhe nuk i lejon në mënyrë të pavarur të vendosë nëse do të japë pëlqim për përpunimin e vëllimit

konkret të të dhënave, dhe i njëjti shfrytëzon pëlqim të kombinuar dhe të kushtëzuar për të gjitha llojet e biskotave.

Shembulli 1

Kjo ueb faqe shfrytëzon biskota. Pranimi i biskotave mundëson shfletim optimal të përmbajtjeve të ueb faqes.

OK

Ne shfrytëzojmë biskota që ta përmirësojmë përvojën gjatë shfrytëzimit të ueb faqes tonë. Me klikim të ndonjë linku të kësaj faqeje ju e pranoi përdorimin e biskotave.

PRANO

Shembull tjetër i kërkesës për pëlqim i cili nuk është në pajtim me LMDHP janë dritaret lëvizëse ose afishe me njoftim të formuluar në mënyrë të ngjashme si nga shembulli paraprak: “*kjo ueb faqe shfrytëzon biskota që të sigurojë përvojë më të mirë shfrytëzuese dhe ju mund të rregulloni cilësimet e biskotave në internet kërkuesin tuaj. Më shumë informacione për biskotat, si i shfrytëzojmë si dhe si ti shkyçni mund të lexoni [këtu](#).*” ose “*Ne shfrytëzojmë biskota për qëllime të ndryshme, për shembull, për funksionalitetin e ueb faqes, për përvojë më të mirë shfrytëzuese, për sigurimin e qasjes së shpejtë dhe integrim me rrjetet sociale dhe për shfaqje të përmbajtjeve reklamuese (të personalizuar).* Nëpërmjet mbetjes në ueb faqe, ju pajtoheni të shfrytëzoni biskota, por jo edhe të dhëna personale. [Për më shumë informacione...](#)” dhe butonat me tekst, si për shembull “OK”, “Pranoj”, “Pajtohem” ose tekst të ngjashëm. Klikimi i linqeve për më shumë informacione hap dritare të re lëvizëse ose ueb faqja me përmbajtje informative i përshkruan biskotat që i shfrytëzon ueb faqja dhe për çfarë qëllimi, por nuk jep mundësi shfrytëzuesi të zgjedhë grupe të biskotave sipas qëllimit të tyre për të cilat jep pëlqim. Shfrytëzuesi këshillohet të rregullojë cilësimet për biskotat nëpërmjet internet-kërkuesit të tij, me udhëzim për atë se ku mund të gjenden instruksione plotësuese për rregullimin e cilësimeve për lloj konkret të biskotave në internet- kërkuesin. Këto shembuj e theksojnë qëllimin e grumbullimit të të dhënave personale të shfrytëzuesi, por nuk i lejojnë të vendosë nëse dëshiron të japë pëlqim për përpunim të vëllimit konkret të të dhënave nëpërmjet biskotave dhe shfrytëzojnë pëlqim të kombinuar dhe kushtëzuar për të gjitha llojet e biskotave (me klikim të butonit “OK”, “Pranoj”, “Pajtohem” ose tekst të ngjashëm).

Shembulli 2

Kjo ueb faqe shfrytëzon biskota që të sigurojë përvojë më të mira shfrytëzuese dhe ju mund të rregulloni cilësimet për biskotat në internet kërkuesin tuaj. Më shumë informacione për biskotat, si i shfrytëzojmë si dhe si të ç’kyçen mund të lexoni [këtu](#).

OK





1. Çka janë biskotat?

Biskotat janë.....

2. Menaxhimi me biskotat

Cilësimet për biskotat mund t'i kontrollojmë dhe përshtatim përmes rregullimit të cilësimeve të internet-kërkuesit që e shfrytëzoni. Nëse nuk pajtoheni me shfrytëzimin e biskotave, lehtë mund t'i fshini (ose pamundësoni) në kompjuterin tuaj ose pajisjen mobile.

3. Çfarë biskota shfrytëzojmë?

Shembull i tretë i kërkesës për pëlqim i cili nuk është në përputhje me LMDHP janë dritaret lëvizëse ose afishe me njoftim për shfrytëzuesin me përmbajtjen si vijon: *“Kjo ueb faqe vendos biskota, qaset deri te të dhënat e përgjithshme dhe jo sensitive nga pajisja juaj dhe i shfrytëzon që t'i përmirësojë prodhimet në ueb faqe dhe t'i përshtatë reklamat dhe përmbajtjet tjera të ueb faqes. Ju mund t'i pranoni të gjitha ose një pjesë nga këto procedura. Për më shumë informacione për biskotat si dhe si interneti i shfrytëzon informacionet tuaja, dhe që të shihni opsionet që ju qëndrojnë në dispozicion, vizitoni faqen [Politika për biskotat](#).”* Nën njoftim të rezymuar janë theksuar funksionet e grupeve të biskotave me përshkrim të shkurtër me qëllimin e tyre, siç janë:

- "Hulumtime të tregut për gjenerim të kontrollit në auditor.

Mund të shfrytëzohen hulumtimet e tregut për marrjen e më shumë informatave për auditorin që i viziton ueb faqet/ aplikacionet dhe kontrollojnë reklama.”

-“Matja e efektivitetit të përmbajtjeve.

Mund të matet efektiviteti dhe efikasiteti i përmbajtjeve të cilat i kanë kontrolluar ose me të cilat hyjnë në interaksion.”

- „Matja e performancës së reklamave.

Mund të matet efektiviteti dhe efikasiteti i reklamave të cilat i keni parë dhe me të cilat hyni në interaksion.”

- „Krijimi profil për përmbajtje të individualizuara.

Mund të krijohet profil për ju dhe për interesat tuaja që të shfaqen përmbajtje të individualizuara. “

- „Zgjedhje të përmbajtjeve të individualizuara.

Mund të ofrohet shfaqje e përmbajtjeve të individualizuara në bazë të profilit të krijuara për ju.”





- „krijimi i profilit për reklama të individualizuara.

Mund të krijohet profil në bazë të interesave tuaja që të shfaqin reklama të individualizuara që mund t’ju interesojnë.”

- “Zgjedhja e reklamave të individualizuara.

Mund të ofrohet shfaqje e përmbajtjeve të individualizuara në bazë të profilit të krijuara për ju.”

- „Zgjedhja e reklamave bazë.

Reklamat që shfaqen bazohen në përmbajtjet që i keni parë ose aplikacionet që i shfrytëzoni.”

